



Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, mbështetur në nenin 28 paragrafi (1) Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03/L-229 data: 07. tetor 2010, Gazeta zyrtare nr. 88/25 nëntor 2010 dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës nën 16 para. 1 si dhe nenin 10 par.2, nenin 12. Par. 1.3, dhe 4.1 të Statutit të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës nr. 04-V-312 data 24.08.2012, në mbledhjen e mbajtur me datën 19.12.2018 miratoj:

**RREGULLOREN NR. 04/2018
E PUNËS SË KOMISIONIT TË AUTORITETIT KOSOVAR TË
KONKURRENCËS**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave dhe parimeve për organizimin e punës dhe funksionimin efikas të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

**Neni 2
Komisioni**

1. Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është organ kolegjal që menaxhon me punën e Autoritetit, përbëhet nga pesë (5) anëtarë, njeri prej të cilëve është kryetari i Komisionit.
2. Autoritet Kosovar i Konkurrencës përfaqësohet nga Kryetari i Komisionit.
3. Në rast mungese të Kryetarit, AKK përfaqësohet nga zëvendëskryetari ose i autorizuari tjetër nga Kryetari i Komisionit të AKK-së.
4. Kryetari i Komisionit të AKK-së udhëheq organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës dhe është përgjegjës për punën profesionale të Autoritetit.

**Neni 3
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

1. Propozon dhe miraton aktet nënligjore në bazë të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e Konkurrencës
2. Merr vendime me të cilën Autoriteti e inicion dhe udhëheq procesin e përcaktimit të çrregullimit të konkurrencës;
3. Shqipton masa ndëshkuese për shkelje të këtij ligji;
4. Përcakton afatet dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre;
5. Përfundon procedurat dhe përcakton masat, kushtet dhe afatet për rivendosjen e konkurrencës efektive të tregut;

6. Merr vendim mbi bazën e të cilit Autoriteti i parashtron kërkesë Gjykatës kompetente për lëshimin e urdhrit për të hetuar pa paralajmërim paraprak në selinë ose objekte tjera, depove të hapura dhe mjetet transportuese, dokumentet personale dhe gjësende që gjenden atje si dhe vulosjen me plumb dhe sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të hetimit bazuar në nenin 40 paragrafi 1. dhe nenit 42 të këtij ligji;
7. Promovon në mënyrë aktive njohuritë për konkurrencën në treg, respektivisht ngritë nivelin e vetëdijesimit dhe informimit për rolin e politikës së konkurrencës tregtare;
8. Jep opinione për harmonizimin e projekt-ligjeve dhe rregulloreve të tjera me këtë ligj;
9. Propozon bazën metodologjike për hulumtimin e konkurrencës së tregut përmes udhëzimit administrativ;
10. Përcakton rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës;
11. Me kërkesë të Kuvendit, Qeverisë si dhe institucioneve publike qendrore dhe lokale jep mendim profesional për çështjet në fushën e politikës dhe të drejtës së konkurrencës tregtare;
12. Bashkëpunon me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare në fushën e konkurrencës lidhur me përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, të transferuara në kompetencat e Autoritetit;
13. Miraton raportin vjetor për punën e Autoritetit dhe të njëjtin ia paraqet Kuvendit të Kosovës më së largu deri me 31 mars të vitit vijues.

Neni 4

Përgjegjësitë e Komisionit lidhur me menaxhimin e AKK-së

1. Komisioni i AKK-se miraton emërimet dhe shkarkimet e personelit të Autoritetit në përputhje me procedurat e parashikuara në Ligjin për Shërbimin Civil;
2. Udhëzon departamentin dhe personelin përkatës për detyrat dhe kompetencat specifike;
3. Deleton detyra administrative Sekretarit.

Neni 5

Sekretariati i AKK-së

1. Sekretariati ofron mbështetje administrative për Komisionin për zbatimin e funksioneve dhe përgjegjësi të Komisionit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë, organizimi dhe sistematizimi i vendeve të punës të sekretariatit përcaktohet me rregulloren nr. 03/2018.
3. Sekretariati i AKK-së udhëhiqet nga Drejtori i përgjithshëm i cili është nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues.

Neni 6

Procedura e emërimit të drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

1. Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës emërohet nga Komisioni i AKK-së përmes procedurave të konkursit publik.
2. Mandati i drejtorit të përgjithshëm është tre (3) vjeçar me mundësi vazhdimi.
3. Konkursi publik për emërimin e drejtorit të përgjithshëm shpallet nga Komisioni i AKK-së dhe të gjitha procedurat e emërimit të përcaktuara në këtë rregullore zhvillohen nga Komisioni.
4. Kriteret e konkursit për pozitën e drejtorit të përgjithshëm përcaktohen sipas përshkrimit të kësaj pozite në Rregulloren nr. 03-2018.
5. Komisioni i AKK-së përcakton Komisionin përzgjedhës për rekrutimin e drejtorit të përgjithshëm në përbërje prej tre (3) anëtarëve të Komisionit të AKK-së. Propozimin e Komisionit përzgjedhës e bënë Kryetari i AKK-së.

6. Komisioni përzgjedhës është i obliguar që t'i zhvilloj procedurat e rekrutimit përshtatshëmrisht me rregullat dhe procedurat për emërimin e nëpunësve civil të pozitave të nivelit të lartë drejtues.
7. Komisioni përzgjedhës është i obliguar që pas përfundimit të procedurave të rekrutimit në afat prej 7 (shtatë) ditësh, t'ia paraqesë Kryetarit të Komisionit të AKK-së listen me 3 (tre) kandidatë me të sukseshme.
8. Kryetari i Komisionit të AKK-së në afat prej 7 (shtatë) ditësh obligohet që t'i rekomandoj Komisionit të AKK-së njërin prej tre kandidatëve të sukseshëm.
9. Komisioni i AKK-së vendos lidhur për kandidatin e rekomanduar nga Kryetari. Nëse kandidati i rekomanduar nga Kryetari nuk merr shumicën e votave të mjaftueshme tre (3) vota, atëherë Komisioni i AKK-së vendos në mes dy (2) kandidatëve të mbetur në listë.
10. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk merr shumicën e votave të mjaftueshme të Komisionit të AKK-së konkursi për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKK-së përsëritet.

Neni 7

Procedurat e shkarkimit të Drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës

1. Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës shkarkohet nga Komisioni i AKK-së për shkak të:
 - 1.1. Përformancës së dobët
 - 1.2. Me vendim të komisionit dëpiplinorë për shkak të kryerjes së shkeljeve të renda.

Neni 8

Vlerësimi i përfomancës së Drejtorit të përgjithshëm

1. Vlerësimin e përfomancës e kryen një Komision në përbërje prej tre (3) anëtarëve si në vijim:
 - 1.1. Dy (2) anëtarë të Komisionit të AKK-së, dhe
 - 1.2. Një anëtarë nga nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues të institucioneve qendrore të administratës publike.
2. Komisionin për vlerësimin e përfomancës e themelon Kryetari i Komisionit të AKK-së.
3. Komisioni paraqet raport me shkrim lidhur me përfomancën e drejtorit të përgjithshëm dhe i rekomandon kryetarit të Komisionit të AKK-së. Kryetari i AKK-së, duke u bazuar në raportin dhe rekomandimet e Komisionit vlerësues merr vendim lidhur marrëdhënjen e punës së drejtorit të përgjithshëm.
4. Lidhur me vlerësimin e përfomancës, Komisioni vlerësues aplikon përshtatshëmrisht dispozitat përkatëse për nëpunësit e nivelit të lartë drejtues, nëse ndonjë procedurë nuk është e rregulluar specifikisht me dispozitat e kësaj rregullore.
5. Vlerësimi i punës i drejtorit të përgjithshëm të AKK-së bëhet nga Kryetari i AKK-së përshtatshëmrisht sipas dispozitave përkatëse për nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues.

Neni 9

Inicimi i procedurës dëpiplinore

1. Inicimi i procedurës dëpiplinore ndaj drejtorit të përgjithshëm ka të drejtë ta bëjë, Kryetari i AKK-së ose së paku 2 anëtarë të Komisionit të AKK-së. Anëtarët e Komisionit të AKK-së të cilët e inicojnë procedurën dëpiplinore nuk kanë të drejtë që të jenë pjesë e Komisionit dëpiplinore.
2. Komisioni dëpiplinor themelohet me vendim të Kryetarit të AKK-së në këtë përbërje:
 - 2.1. Dy (2) anëtar të Komisionit, dhe

- 2.2. Një anetar nga nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues të institucioneve qendrore të administratës publike.
3. Komisioni disiplinor shqyrton rastin lidhur me pretendimet e ngritura për shkelje të detyrave të punës ose shkelje që dëmtojnë imazhin e institucionit nga Drejtori i përgjithshëm dhe në bazë të dëshmive merr vendim lidhur me rastin e inicuar duke aplikuar pështatshmërisht dispozitat përkatëse për nëpunësit e nivelit të lartë drejtues, nëse ndonjë procedurë nuk është rregulluar specifikisht me dispozitat e kësaj rregullore.

Neni 10

E drejta e Ankesës

1. Në rast se Drejtori i përgjithshëm është i paknaqur me vendimin e Komisionit disiplinor ose me vendimin e Kryetarit të AKK-së që kanë të bëjnë me marrëdhënjen e tij të punës, ai ka të drejtë që brenda afatit prej tridhjet (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të parashtrij ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Neni 11

1. Komisioni merr vendime në mbledhje që mbahen sipas nevojës, në parim 2 herë në muaj.
2. Mbledhjet e komisionit mbahen sa herë që është e nevojshme bazuar në kërkesat që dalin nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, për të cilën vendosë Kryetari i Komisionit.
3. Mbledhjen e komisionit e thërret Kryetari i Komisionit. Në mungesë të Kryetarit mbledhjen e thërret zëvendëskryetari i Komisionit dhe nëse zëvendëskryetari mungon atëherë mbledhjen e thërret anëtar i komisionit i emruar nga Kryetari i AKK-së vetëm në raste të jashtëzakonshme.
4. Kryetari i Komisionit të AKK-së organizon aktivitetet e Komisionit, e bënë ndarjen e detyrave në mes të anëtarëve të Komisionit, ju ofron dhe ju interpreton anëtarëve të Komisionit vendimet e organeve relevante të cilat e prekin fushën e konkurrencës, i kryeson mbledhjet e Komisionit të konkurrencës dhe i adreson qështjet e tjera të parapara me Ligj dhe Statut për zgjidhje në komisionin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

PREGATITJA DHE ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE TË KOMISIONIT TË AKK-SË

Neni 12

1. Rendi i ditës propozohet nga Kryetari i AKK-së bazuar në kërkesat që dalin nga Komisioni dhe Administrata e AKK-së.
2. Kryetari i Komisionit në bazë të pikave të rendit të ditës cakton kohën e mbledhjes së Komisionit të AKK-së.
3. Me propozimin e agjendës për rend të ditës, asistentja ekzekutive është e detyruar t'i shumojë dhe t'i shpërndajë anëtarëve të Komisionit agjenden dhe dokumentacionin përcjellës.
4. Përfshirë nga paragrafi 3 i këtij neni, për shkak të volumit të shkresave, ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm edhe anëtarëve të Komisionit mund t'iu dorëzohen vetëm në kopje elektronike.
5. Anëtarëve të Komisionit për mbledhjen e Komisionit iu dorëzohet, si rregull, pesë ditë para mbledhjes së Komisionit. Në mbledhjen e Komisionit mundet, të ketë pika shtesë në rendin e ditës të mbledhjes së Komisionit, të cilat nuk janë të përfshira në agjendën e rendit të ditës në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, me kusht që materiali për këto pika t'iu dorëzohet anëtarëve të Komisionit të paktën një ditë para seancës së Komisionit.

6. Përfshirë nga paragrafi 5 i këtij neni, në raste urgjente dhe me pëlqimin e Kryetarit të Komisionit, materiali mund të përfshihet në rendin e ditës të mbledhjes së Komisionit edhe pa dërgimin e materialeve anëtarëve të Komisionit.

RRJEDHA E MBLEDHJES SË KOMISIONIT DHE MËNYRA E PUNËS

Neni 13

1. Mbledhjen e Komisionit e kryeson Kryetari i Komisionit.
2. Në mbledhjet e Komisionit marrin pjesë anëtarët e Komisionit, Drejtori i përgjithshëm, udhëheqësit e procedurave, asistentja në cilësinë e procesmbajtësit si dhe punonjësit tjerë profesional të ftuar nga Kryetari i Komisionit të AKK-së.
3. Të përmendurit në paragrafin 2 të këtij neni janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjen e Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.
4. Të përmendurit në paragrafin 2 të këtij neni janë të obliguar që një ditë më herët ta informojnë Kryetarin e Komisionit të AKK-së për mos pjesëmarrje në mbledhje.
5. Pas hapjes së mbledhjes, Kryetari i Komisionit konstaton praninë e anëtarëve të Komisionit dhe personave të tjerë të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, e cila regjistrohet dhe hynë në procesverbal.
6. Mbledhjet e Komisionit inçizohen me aparate inçizuese të lejuara nga Kryetari i Komisionit të AKK-së.

Neni 14

1. Rendi i ditës miratohet në bazë të propozimit që i'u është shpërnda anëtarëve të Komisionit, si dhe me propozim të Kryetarit të Komisionit pikat e rendit të ditës mund të plotësohen, largohen, dhe të shtohen pika të reja.
2. Secili anëtar i Komisionit mund të propozojë plotësimin, largimin apo shtimin e pikave të reja në rend të ditës, dhe se propozimi i tij duhet të arsyetohet. Pas kësaj votohet për rendin e ditës.
3. Pas miratimit të rendit të ditës vazhdon diskutimi dhe vendosja për pikat e radhes.
4. Pikë e veçantë e rendit të ditës, së paku një herë në muaj do të jetë Rishikimi i zbatimit të vendimeve të mbledhjeve paraprake.

Neni 15

1. Administrata e AKK-së është e detyruar që të paktën një herë në muaj të informoj Komisionin për gjendjen e procedurës në çdo lëndë veç e veç.
2. Materiali për mbledhjen e Komisionit sipas nenit 4 paragrafi 3 të kësaj Rregulloreje, si rregull përmbanë: Një kopje të iniciativës për ngritjen e procedurës ose njoftimin e qëllimit të përqendrimit, respektivisht kopje tjetër të paraqitësit të kërkesës, faktet e konstatuara dhe propozimin e vendimit me të cilin shërbimi profesional rekomandon vazhdimin ose ndërprerjen e procedurës.
3. Materiali nga paragrafi 2 i këtij neni mund të përmbajë edhe dokumente tjera, në varësi të llojit dhe kompleksitetit të çështjes që diskutohet në Komision.

Neni 16

1. Secilën pikë të rendit të ditës, fillimisht e shpjegon zyrtari që ka udhëheqë procedurën respektivisht raportuesi.
2. Pas shpjegimit të zyrtarit raportues, kryetari i Komisionit nëse e konsideron të nevojshme për shpjegim shtesë t'ua jap fjalën edhe punonjësve tjerë të ftuar të Administratës.
3. Pas arsyetimit të lëndes nga punëtorët e Administratës, Kryetari i Komisionit u jep fjalën anëtarëve të Komisionit, të cilët mund të kërkojnë informacion ose sqarime shtesë nga punonjësit e Administratës.
4. Personi i cili merr fjalën është i detyruar që në fjalimin e tij të jetë i qartë dhe konciz, dhe diskutimin e tij ta kufizoj vetëm në temën e prezantimit.
5. Kryetari i Komisionit ka të drejtë t'ia marrë fjalën në qoftë se pjesëmarrësi në diskutim nuk u përmbahet rregullave të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.
6. Pas debatimit të të gjitha pyetjeve, anëtarët e Komisionit vendosin për ecurinë e mëtejme.

Neni 17

1. Mbledhja e Komisionit zakonisht zgjatë deri në shterimin e të gjitha pikave të miratuara të rendit të ditës.
2. Në qoftë se në mbledhjen e Komisionit nuk mund të diskutohen të gjitha pikat e rendit të ditës, anëtarët e Komisionit mund të vendosin të ndërprehet mbledhja dhe të vendoset data dhe ora e vazhdimit të mbledhjes.

METODAT E VOTIMIT

Neni 18

1. Vendimi kërkon një shumicë të të gjithë anëtarëve të Komisionit. Në secilen mbledhje të Komisionit detyrimisht do të marrë pjesë Kryetari ose Zëvendëskryetari i Komisionit.
2. Nëse një anëtar i Komisionit sygjeron ndryshimin e një propozim - vendimi, së pari votohet për ose kundër propozimit të anëtarit të Komisionit, dhe pastaj projekt-vendimi i propozuar.
3. Pas përfundimit të diskutimit për secilen pikë veq e veq të rendit të ditës, Komisioni vendos me të paktën tri vota.
4. Anëtar i pranishëm në takim të Komisionit nuk mund të abstenojë gjat votimit.
5. Në mbledhjet e Komisionit anëtarët votojnë publikisht. Pas votimit konstatohet se sa vota kanë qenë për, dhe sa vota kundër miratimit të vendimit të propozuar, dhe të dhënat mbi votimin e anëtarëve të Komisionit hynë në procesverbal.

Neni 19

1. Në rast se në mbledhje nuk marrin pjesë numri i kërkuar i anëtarëve të Komisionit, përkatësisht në mbledhje nuk merrë pjesë kryetari ose zëvendëskryetari i Komisionit, takimi shtyhet.
2. Kryetari i Komisionit në këtë rast cakton një datë të re të mbajtjes së mbledhjes.
3. Në raste të jashtëzakonshme, Kryetari ose Zëvendëskryetari i Komisionit mund të thërrasë mbledhjen me telefone në të cilën anëtarët e Komisionit votojnë në një nga mënyrat e mëposhtme: - me telefon - me faks ose - me e-mail.

4. Vendimi i Komisionit i marrë në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni konfirmohet në mbledhjen e ardhshme të Komisionit gjatë miratimit të procesverbalit.
5. Personat e autorizuar për të kryer detyrën zyrtare të AKK-së përjashtohen në rast se kanë konflikt të interesit, të përcaktuar me nenin 52 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

PROCESVEBALI DHE VENDIMET NGA MBLEDHJA

Neni 20

1. Procesverbalin e mbledhjes e mbanë asistentja e Komisionit –në cilësinë e procesmbajtësit. Procesverbalin duhet të përmbajë vendin, datën, emrat e anëtarëve të pranishëm të Komisionit, emrat e anëtarëve të Komisionit që mungojnë, emrat e punonjësve tjerë të pranishëm të shërbimit profesional, miratimi i rendit të ditës, propozimi i shkurtër i shërbimit profesional vendim i Komisionit për secilën pikë të rendit të ditës si dhe numrin e votave për ose kundër të vendimeve konkrete të Komisionit.
2. Anëtar i Komisionit mund të kërkojë që diskutimi i tij të futet në procesverbal.
3. Anëtar i Komisionit që ka votuar kundër mund të kërkojë që në procesverbal të futet mendimi i tij mospajtues, i cili është i detyruar të diktoj në procesverbal apo mendimin e tij kundërshtues mund ta paraqes me shkrim brenda dy ditëve pas përfundimit të mbledhjes së Komisionit.
4. Në rast mungese të Asistentës, kryetari i Komisionit përcakton procesmbajtësin për çdo mbledhje.

Neni 21

1. Procesverbalin duhet të bëhet me shkrim në gjashtë kopje origjinale, nga një për secilin anëtar të Komisionit, dhe i gjashti ruhet në arhive të AKK-së.
2. Procesverbalin i mbledhjes së kaluar të Komisionit, para miratimit të rendit të ditës së mbledhjes, miratohet nga Komisioni me shumicën e votave të Komisionit.
3. Procesverbalet nga mbledhja e Komisionit janë në dispozicion të punonjësve të Autoritetit përmes faqes Intranet të Autoritetit.
4. Incizimet me zë nga mbledhja ruhen në Zyrat e Komisionit, si dhe për ruajtjen e tyre është i ngarkuar procesmbajtësi. Të drejtën e dëgjimit të incizimit me zë të mbledhjes së Komisionit e ka secili anëtar i Komisionit në prani të procesmbajtësit.
5. Incizimi me zë i seancës së Komisionit, procesverbalin me shkrim, vendimet nga mbledhja e Komisionit, si dhe të gjitha shtojcat tjera të procesverbalit do të mbahen në përputhje me rregullat për mbrojtjen e arkivave.

I. NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I RREGULLORËS

Neni 22

1. Ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Rregulloreje mund të propozojë çdo anëtar i Komisionit, dhe bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e sajë.

II. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16

1. Komisioni është përgjegjës për interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 17


1. Me aprovimin e kësaj rregullore shfuqizohet rregullorja nr.02/2016 e dt. 26.08.2016

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni i AKK-se.

KOMISIONI I AUTORITETI KOSOVAR TE KONKURRENCËS


Valon Prestreshi
Kryetar

()
Ahmet Krasniqi
zv . Kryetar

()
Fatime Haziri
Anëtare

()
Muhamed Krasniqi
Anëtar

()
Shaqir Morina
Anëtar

